



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
BORDI I DREJTORËVE

Nr. ⁴⁴⁶..... Prot.

Tiranë, më ²⁸.... 03.2024

Vendim nr. ³⁶___ datë ²⁸___3.2024

Mbështetur në nenin 65 (*Bordi i drejtorëve të instituteve dhe njërive kërkimore-shkencore*) dhe nenin 66 (*Funksionet e bordit të drejtorëve*), të Statutit të Akademisë së Shkencave, si dhe pas diskutimeve sipas rendin e ditës (bashkëlidhur), më datë 20.03.2024, u mbledh bordi i drejtorëve, i cili,


Vendosi:

1. Lista me 32 titujt e veprave të instituteve të albanologjisë të miratuara për botim vitin e kaluar nga këshillat shkencorë të tyre, që barten si detyrim i trashëguar, për shkak të vonesave në prokurim, i kalojnë programit të veprimtarisë botuese të këtij viti dhe i bashkohen titujve të veprave të vitit 2024;
2. Dorëzimin e marrëveshjeve pranë sektorit të marrëdhënieve me jashtë për të njoftuar palët e tjera për ndryshimin e statusit të instituteve, si pjesë tashmë të ASHSH.
3. Rekomandoi rishikimin e përbërjes së këshillit të botimeve për një përfaqësim më të mirë të instituteve të albanologjisë;
4. Të ngrihet një grup pune me 4 anëtarë për hartimin e një platforme e kalendari për zhvillimin e diskutimit të problemeve në lidhje me riorganizimin e instituteve dhe akteve rregulluese;

5. Të nxisë bashkëpunimin e njësive me Qendrën për Koordinimin dhe Përhapjen e Informacionit Shkencor e shërbimin bibliotekar, veçanërisht për krijimin e bazës së të dhënave të punonjësve kërkimor-shkencor;
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR





**REPUBLIKA E SHQIPERISE
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA**

Tiranë, më 15.03.2024

Mbledhje e bordit të drejtorëve dt. 20.03.2024, ora 14.00

Rend dite:

- 1. Mbi botimet e vitit 2023 dhe 2024 të njësive kërkimore shkencore të albanologjisë – mendime për to.**
- 2. Mbi marrëdhëniet me jashtë me institucionet homologe dhe marrëveshjet në fuqi (dokumentacioni nga drejtuesit e instituteve të albanologjisë dhe QSA).**
- 3. Mendime për këshillin e botimeve dhe përbërjen e tij (bashkëlidhur, Rregullore e veprimtarisë botuese të ASH, në vëmendje neni 3 i saj dhe përbërja aktuale e këshillit të botimeve).**
- 4. Disa probleme të Institutit të Arkeologjisë: Për Butrintin dhe Durrësin.**
- 5. Ngritja e një grupi pune për përgatitjen e një platforme për çështje që lidhen me riorganizimin e instituteve; aktet statutore; rregulloret; ristrukturimi, etj.**
- 6. Mbi riorganizimin e bibliotekave dhe arkivave të ASHSH (materiali bashkëlidhur).**